



🏠 Faqja Kryesore / Aktualitet

[Aktualitet](#) [Flash](#) [Te Fundit](#) [Te Gjitha](#)

Tenton t'i arratiset policisë, arrestohet 29-vjeçari i armatosur

• 16/04/2019 0



^

Një 29- vjeçar është arrestuar paraditen e sotme në qytetin e Vlorës për armëmbajtje pa leje dhe tentativë për t'iu larguar policisë.

Personi me initiale E.H i cili u zbulua nga Policia pranë Ujit të Ftohtë është përpjekur të arratiset në momentin që ka parë forcat e rendit.

Në njoftimin e Policisë përsoni i arrestuar E.H banues në Vlorë kishte precedent të mëparshëm penal në fushën e armëmbajtjes pa leje.

Policia i sekuestroi 29-vjeçarit një armë zjarri CZ-P09, me 16 fishekë.

Njoftimi i policisë:

Vlorë

Qarkullonte me armë zjarri në qytet, qytetarët njoftojnë Policinë.

Tentoi ti largohej Policisë por kapet në flagrancë gjatë ndjekies.

29 vjeçari me precedent të mëparshëm penal në fushën e armëmbajtjes pa leje.

Sekuestrohet një armë zjarri pistoletë dhe 16 fishekë.

Në vijim të bashkëpunimit mes Policisë dhe qytetarëve për të parandaluar dhe goditur paligjshmërinë, qytetarët kanë njoftuar Policinë për një shtetas i cili qarkullonte me armë zjarri me vete në zonën e Ujit të Ftohtë.

^

Menjëherë janë organizuar shërbimet e policisë, të cilët kanë konstatuar pranë një lokali në Ujin e Ftohtë Vlorë personin e dyshuar, i cili sapo ka parë Policinë ka tentuar të largohet.

Shërbimet e Policisë janë vënë në ndjekje ku kanë bërë të mundur kapjen në flagrancë të shtetasit E.H., 29 vjeç, banues në Vlorë.

Shtetasi E.H., gjatë tentativës për ti shpëtuar Policisë, ka hedhur në tokë armën e zjarrin tip pistoletë CZ-P09, me 16 fishekë.

29 vjeçari ka qenë edhe më parë i arrestuar nga Policia për armëmbajtje pa leje në vitin 2012.

Materialet iu referuan Prokurorisë për veprat penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe “Mosbindja ndar urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik”.

Policia e Vlorës falënderon qytetarët për besimin dhe bashkëpunimin dhe fton cilindo për të denoncuar çdo paligjshmëri duke ju garantuar anonimat të sigurtë dhe reagim të menjëhershëm e të paanshëm. (J.B/Faxweb.al)

 Fjalët Kyce

arrestohet 29 vjeçari ne VLORE [<https://www.faxweb.al/etiketa/arrestohet-29-vjecari-ne-vlore/>]

Për t'ju bashkuar grupit të Faxweb.al në Facebook, klikoni [Join Group](#)

Sponsored by 

^